



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 5138/1 Prot.

Tiranë më, 1 / 3 /2019

TË GJITHA DEPARTAMENTEVE në DPD
TË GJITHA DREJTORIVE në DPD
TË GJITHA DEGËVE DOGANORE

Lënda: Njoftim akti

Ju bëjmë me dije se është miratuar udhëzimi Nr.2, datë 1.03.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.2, datë 15.01.2018 “Mbi zbatimin e procedurave për deklarimin dhe çlirimin për qarkullim të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje “on-line” nga individët nëpërmjet operatorëve postarë”, kopjen e të cilit e gjeni bashkëlidhur.

Udhëzimi të publikohet në faqen web të doganës.

Merrni masat për njohjen dhe zbatimin me korrektesë të tij!

Duke Ju falenderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda Ikonomi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 5138 Prot.,

Tiranë, më 01/13 /2019

UDHËZIM

Nr. 2 datë 1/13 /2019

Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 2, dt. 15.01.2018 “Mbi zbatimin e procedurave për deklarimin dhe çlirimin në qarkullim të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje “on-line” nga individët nëpërmjet operatorëve postarë”

Mbështetur në nenet 52, 184(3)(d)(dh), të Ligjit 102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, dhe në nenet 420 deri 424, të VKM nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

Me qëllim qartësimin, standardizimin dhe shmangien e procedurave administrative rënduese (për individët dhe autoritetin doganor), për deklarimin në doganë të mallrave me natyrë jo tregtare nga individë, vlera e të cilave nuk kalojnë kufirin e dërgesave me vlerë të papërfillshme;

Bazuar në nenin 737, të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin nr. 2, dt. 15.01.2018 “Mbi zbatimin e procedurave për deklarimin dhe çlirimin në qarkullim të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje “on-line” nga individët nëpërmjet operatorëve postarë” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pjesën 1, Përkufizime, pika 1.7, ndryshon si vijon:

“1.7 “Mallra me vlerë të papërfillshme” janë mallra, vlera në vetvete e të cilave, nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë, sipas përcaktimeve në Aneksin 1.”

2. Në Aneksin 1, paragrafi i parë i Pjesës I, “Mallra me vlerë të papërfillshme” ndryshon si vijon:

“Në përputhje me nenin 420, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, çdo dërgesë mallrash me karakter jotregtar, e

përbërë nga mallra me vlerë të papërfillshme, të dërguara drejtpërdrejt nga një vend tjetër te një individ marrës në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 22 euro, përjashtohet nga taksat dhe tatimet në import. Në vlerën e papërfillshme përfshihet vetëm çmimi i paguar për mallin në vetvete dhe jo shpenzime të tjera si ato të transportit, siguracionit etj.

Psh, nëse një këmishë është blerë on-line me një çmim 20 euro dhe shpenzimi i transportit është 5 euro, atëherë në këtë rast kemi të bëjmë me mall me vlerë të papërfillshme, sepse çmimi i këmishës në vetvete është nën kufirin prej 22 euro.

Nëse këmisha blihet me një çmim në vetvete prej 23 euro dhe shpenzimi i transportit është 5 euro, atëherë në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me mall me vlerë të papërfillshme. Në këtë rast për të përlogaritur detyrimet që duhen paguar në doganë, shumës prej 23 euro do t'i shtohen edhe shpenzimet e transportit.”

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Belinda IKONOMI

